



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia.org. Org./Division Org./Unit	SP-02
Nr. i Faqes/W No. Stranica No. Pages	-09-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	699-2/24
Data Datum Date	23.09.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.09.2024
REFERENC-Ë:	24/699/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"GRANIT", Sh.p.k., Istog, Bazë për prodhimin e Betonit, Suhadoll, Graçanicë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "GRANIT", Sh.p.k., Istog, me nr.prot. 24/699/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Suhadoll, Graçanicë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/699/MMPHI  
Datë: 03.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1.2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Operatori, "GRANIT", Sh.p.k., Istog, me nr.prot. 24/699/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betoni, Suhadoll, Graçanicë, në ngastrat nr.00381-1; nr. 00383-3, zona kadastrale Suhadoll.
2. Operatori obligohet:
  - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
  - 2.2. Sistemi de- pluhurues të jetë funksional;
  - 2.3. Shfrytëzimi dhe shkarkimi i ujërave të bëhet ne përputhje me Lejet Ujore;
  - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
  - 2.5. Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqes operacionale;
  - 2.6. Të monitorohet në vazhdim emisionet në ajër dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.

- 2.7. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.8. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

### **A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, “GRANIT”, Sh.p.k., Istog, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Suhadoll, Graçanicë, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqimit Mjedisor nr. 20/2898/1-ZSP/20, të lëshuar me datë: 12.08.2020;
- Leje për aktivitetet e veçanta për bazën e betonit me Nr. 832/KPMM/2022 të lëshuar me dt. 06.05.2022, me afat të vlefshmërisë deri me 20.04.2027;
- Leje Ujore për shfrytëzim me nr.: 2837/23-ZSP-2024, me dt.05.01.2024;
- Leje Ujore për shkarkimin, me nr.: 2838/23 - ZSP-2024, me dt.05.01.2024;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së